

---

**KËRKESË PËR OFERTË PËR OFRUES SHËRBIM BLERJA E BILETAVE PËR MYSAFIR TË  
FESTIVALIT**

*Procedura për kuotimin e çmimeve*

<b>Numri kërkesës për ofertim:</b>	DF 005 /23
<b>Data e ftesës:</b>	18.04.2023
<b>Data e mbylljes:</b>	05.05.2023
<b>Titulli i kontratës:</b>	Shërbim blerja e biletave për mysafirët e festivalit
<b>Autoriteti Kontraktues</b>	Dokufest
<b>Adresa:</b>	Dokufest - Rr.Marin Barleti Pn.,20000 Prizren
<b>E-mail:</b>	info@dokufest.com

**PËRMBLEDHJE**

DokuFest ju fton të paraqisni ofertat për:

**KËRKESË – Shërbim blerja e biletave për mysafirët e festivalit**

Qëllimi i kësaj ftese për ofertim është të identifikojë ofruesit e kualifikuar për shërbimet e kërkuara. Ftesa për ofertë është për një subjekt tregtar/agjensi udhëtimi për rezervimin dhe blerjen e biletave të udhëtimit ajror ndërkombëtar (ardhje & vajtje) për mysafirët e festivalit të cilët do të udhëtojnë për në Kosovë në datat nga 04 – 12 Gusht 2023.

Mysafirët janë nga vendet të ndryshme të botës dhe nga kompanitë kërkojnë ofertë shërbimin - asistencë nga një staf i caktuar për një kohë prej 12 orë gjatë ditës për shërbim dhe komunikim në lidhje me rezervimet, procesimet apo edhe anulimet. Pritet të kemi deri në 260 mysafirë.

Kompanitë e ndryshme dhe profesionistët duhet të ofertojnë sipas kërkesës të paraqitur në këtë dokument.

**KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE**

Të gjithë të ftuarit duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim
- Duhet të shënohet data e ofertës
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 60 ditë),

- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së ( të gjitha në kopje/scan) si dhe licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve.
- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit dhe Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe te ceket cmimi për materialet, propozimet, dhe intervistat (me te gjitha taksat),
- Në rast se TVSH-ja nuk është përcaktuar, Dokufest do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH- në,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze,
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 05.05.2023 ora 24:00.

#### SHËNIM ME RËNDËSI:

- Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.
- Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 5 (pesë) ditë nga data e njoftimit.

#### KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 05 Maj 2023, ora 24:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: [procurement@dokufest.com](mailto:procurement@dokufest.com). Pyetjet pranohen deri më 04 Maj 2023.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 10.05.2023 nga Komisioni përzgjedhës.
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
<b>1. Kriteret Kualitative</b>	
1.1. Pergaditja, pervoja, propozimet konkrete	40%
<b>2. Kriteret Financiare</b>	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	60%
<b>Total:</b>	<b>100%</b>